



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primjeno / Prodato Received / Delivery	06 - 07 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKËMBITAK	3964/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.512/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.512/2022 të datës 08.06.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson Shoqëria e avokatëve [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.512/2022 e datës 08.06.2022, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] punësuar në Policinë e Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesit me autorizim më datë 08.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtave, kualifikimit shkollor dhe pagën e trembëdhjetë, një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit për periudhat 2018, 2019, 2020 dhe 2021 sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.06.2022, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Ndërsa me datë 29.06.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3799/2022 si dhe shkresat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 08.06.2022 me numër protokoll 3326/2022 e parashtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 14.02.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 11.05.2022 për pagesë së shujtave, kualifikimit shkollor dhe pagës shtesë; Kërkesë për pagesë të shujtave, kualifikimit shkollor dhe pagës shtesë e datës 21.03.2022; Vërtetim punësimi i datës 23.02.2022; Urdhër për caktim i datës 10.10.2005; Kontratë pune për kohë të pacaktuar në pozitën Zyrtar i Personelit në stacionin njësia Malishevë e datës 27.05.2014; Kopje e Letërnjoftimit; Diplomë e datës 22.10.2013 me nr.429/1013 e lëshuar nga Kolegji Fama; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.P. i datës 03.01.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i A.P. i datës 19.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i A.P. i datës 03.01.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i A.P. i datës 13.01.2022; Ditët e angazhuara në detyrë; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 14.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 29.06.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 04.09.2015; Përgjigje në kërkesë e datës 22.06.2022; e-mail nga M.G. për V.GJ i datës 22.06.2022; e-mail nga V.GJ. për F.K. i datës 21.06.2022; Dëshmi lidhur me kompenzimin e pagës jubilarë Dhjetor 2015 për A.P.; e-mail nga D.D. për V.GJ. i datës 21.06.2022; e-mail nga H.H. për F.A. i datës 22.04.2021; e-mail zyrtar i datës 20.04.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës konkretisht Kontratës së punës të datës 27.05.2014 është konstatuar se ankuesi [REDAKTUAR] është i punësuar në Policinë e Kosovës në pozitën e punës Zyrtar i Personelit, Drejtoria Rajonale Prizren.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim, më datë 21.03.2022 i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, për njohjen e shpërblimit për shujta ditore, kualifikimit shkollor dhe pagën e trembëdhjetë, dhe atë prej vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021 konform nenit 29 paragrafit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës së Policisë së Kosovës.

Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë i Policisë së Kosovës, me datë 11.05.2022, në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 21.03.2022 ka njoftuar të njëjtin se nuk është aprovuar kërkesa si rrjedhojë e mungesës së mjeteve financiare për pagesën e shujtës ditore, kualifikimit shkollor dhe një pagë mujore (për katër vitet e fundit) në vlerë ekuivalente me pagën e rregullt mujore për muajin e fundit, kualifikimi shkollor dhe shujtës. Pas kësaj përgjigje, ankuesi me datë 08.06.2022 paraqet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës po me bazë të njëjtë ankimore respektivisht kërkon që t'i njihet e drejta e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit për periudhat 2018, 2019, 2020 dhe 2021 shujtës ditore sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar se për kohën sa ka qenë i zbatueshëm Ligji për Shërbimin Civil, stafi civil në Policinë e Kosovës, i është nënshtruar përveç dispozitave ligjore të këtij ligji edhe dispozitave të ligjit të veçantë, gjegjësisht Ligjit për Policinë e Kosovës.



Andaj, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, përkatësisht nenin 47 të këtij ligji ku përcaktohet se: ... 2. Si shtesë e pagës themelore, zyrtarët policor në mënyrë të ligjshme marrin lloje të shtesave, kompensime dhe beneficione..., 3. Shtesat përfshijnë, por nuk kufizohen në kompensime për punë të rrezikshme, punën nën stres, kompensime për orar të punës me ndërrime, pagesa gjatë festave, pagesa për punë jashtë orarit, dhe pagesa për caktim në punë të veçantë. Beneficionet mund të përfshijnë, por jo të kufizohen në, shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet për trajnimet profesionale dhe teknike, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushim me pagesë, kompensimet në rastet e vdekjes, dhe beneficionet e pensionit; 4. Pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe me aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se neni 47 i Ligjit për Policinë e Kosovës, rregullon shtesat, kompensimet dhe beneficionet përtej pagës themelore vetëm për zyrtarët policor, gjegjësisht vetëm për kategorinë e personelit policor të përcaktuar me nenin 44 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Policinë e Kosovës. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit për realizimin e shtesave dhe kompensimeve përtej pagës themelore, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 dhe 2021 e deri e ditën e parashtrimit të ankesës duke u thirrur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, konsiderohen të pa qëndrueshme sepse nuk kanë bazë në Ligjin Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, kurse me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Neni 20 i po të njëjtit ligj ka përcaktuar kompensimet e nëpunësve civil përtej pagës, duke paraparë se: Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.1. kompensim për punë jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 1.2. kompensim për punë jashtë orarit gjatë fundjavës dhe 1.3. kompensim për punë jashtë orarit gjatë festave zyrtare; 1.4. kompensim për pushim vjetor; 1.5. kompensim për kohën e paaftësisë së vërtetuar të përkohshme për shkak të sëmundjes; 1.6. kompensim gjatë shtatzënisë dhe lehonisë; 1.7. kompensim në rast të shfrytëzimit të pushimit të veçantë me pagesë; 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit; 8 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, si vijon: 2.1. shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit gjatë një udhëtimi apo vizite zyrtare brenda ose jashtë Kosovës; 2.2. shpenzimet e shkaktuara me rastin e shfrytëzimit të automjetit personal për punë zyrtare; 2.3. shpenzimet e shkaktuara gjatë punës në terren; 2.4. shpenzimet e shkaktuara me rastin e zhvendosjes së përkohshme ose të përhershme në një vend tjetër pune. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se stafi civil në Policinë e Kosovës, mund të realizoj vetëm kompensimet përtej pagës të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke marr parasysh konstatimin se ligji i veçantë nuk ka rregulluar çështjen e shtesave dhe kompensimeve tjera përtej pagës bazë për stafin civil të Policisë së Kosovës, vlerëson se për këtë kategori të të punësuarve në Policinë e Kosovës, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës më datë 09.07.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin Nr.ref.AGJ 1583/20, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe i njëjti në pikën 211 ka përcaktuar se deri në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët

Publikë nga ana e Kuvendit, dispozitat e këtij Ligji zbatohen vetëm për atë që nuk cenon funksionet dhe organizativet e Institucioneve të Pavarura të referuara specifikisht në Dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi. Rrjedhimisht neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publikë ka shfuqizuar Ligjin Nr.3/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të, andaj, bazuar në këtë dhe duke i referuar nenit 2 paragrafi 3 dhe nenin 19 të këtij ligji, Kolegji konstaton se stafi civil në Policinë e Kosovës kanë statusin e nëpunësit civil dhe të njëjtit mund të realizojnë të drejtat e përcaktuara vetëm sipas dispozitave të këtij ligji dhe ligjit të aplikueshëm për pagat e nëpunësve civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Lënda A nr.512/2022

Çlirim ZEKA

Çlirim
Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

